

Llogari Kursimi për Klientët Individë

Informacion rreth Bankës

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rr.: "Ismail Qemali", Nr. 27,
Kutia postare 8319; 1001 Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 22 76 000; Fax +355 4 22 48 762
Website: www.intesasanpaolobank.al

Karakteristikat dhe Rreziqet e Llogari së kursimit për klientët individë

Karakteristikat e Llogarisë së kursimit

Llogaria e kursimit është një produkt kursimi i cili është i përshtatshëm për të gjithë klientët që kërkojnë të përfitojnë interesa nga kursimet e tyre dhe në të njëjtën kohë mund të përdorin fondet e tyre likuide. Llogaria e kursimit mund të hapet në monedhat LEK, EUR, USD dhe GBP.

Interesi për llogaritë e kursimit llogaritet në bazë të gjendjes më të vogël mujore në llogari dhe kreditohet në llogari në fund të çdo muaji.

Normat e interesit për llogaritë e kursimit publikohen në Kushtet e Punës së Bankës.

Me anë të llogarisë së kursimit ju mund të merrni transferta ose dërgesa të ndryshme nga të afërmit tuaj ose mund të kryeni transferta midis llogarive tuaja, por ju nuk mund të kryeni pagesa ose transferta në nisje. Nëse dëshironi të kryeni pagesa ose transferta në nisje, atëherë ju sugjerojmë të hapni një llogari rrjedhëse.

Tregu i synuar

Llogaria e kursimit është një produkt i krijuar për të gjithë klientët individë

Dokumentet e nevojshme

- Mjet i vlefshëm identifikimi: Pasaportë/Kartë identiteti
- Forma e aplikimit
- Kontrata e Llogarisë së kursimit
- Dokumentacioni i FATCA & CRS
- Specimen i firmës

Rreziqet e Llogarisë së Kursimit

1. Kompensimi i depozitave bazohet në nenin 33, paragrafi 1, pika a) e Ligjit nr. 53/2014, datë 22/05/2014 "Për sigurimin e depozitave", në bazë të të cilit ASD siguron dhe kompenson depozitat e çdo depozituesi në Bankë ose në degën e bankës së huaj deri në masën 100% (përqind), por në çdo rast jo më shumë se Lekë 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë), pavarësisht nga numri i depozitave dhe monedha e tyre, që janë depozituar në Bankë.

2. Në rast se llogaria e kursimeve është në një monedhë të ndryshme nga monedha e të ardhurave, ekziston rreziku që lidhet me luhatjen e kursit të këmbimit.

Kushtet kryesore ekonomike

Lista e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të produktit:	
Normat e interesit (%)	
LEK	0.20
EUR	0.00
USD	0.10
GBP	0.10

Tatim i mbajtur në burim				
Tatimi në burim aplikohet sipas ligjit shqiptar i pagueshëm në momentin e përfitimit të interesit		15% e interesit të përfituar		
Shpenzime të ndryshme				
Nxjerrje llogarie*	100 LEK nxjerrje llogarie për muajin aktual; 200 LEK nxjerrje llogarie për vitin aktual; 500 LEK nxjerrje llogarie për vite të mëparshme * Klienti gëzon të drejtën që 1herë në vit të marrë falas printimin e levizjes së llogarise/ve			
Dërgimi i levizjeve të llogarisë në mënyrë elektronike	Falas			
Dërgimi i levizjeve të llogarisë në adresën e klientit	100 LEK / zarf			
Tërheqje parash në sportelet e Bankës nga llogaria e kursimit	<ul style="list-style-type: none"> 150 LEK për shumat deri në 75,000 LEK (vetëm për tërheqjet në LEK) Falas për shumat deri në 75,000 LEK (për tërheqjet në të gjitha monedhat të ndryshme nga LEK) 150 LEK për shumat deri në 1,500,000 LEK (të gjitha monedhat) 0.10% (max. 2,000 LEK) për shumat mbi 1,500,000 LEK (të gjitha monedhat) 			
Depozitime cash ne sportelet e bankes per llogari personale kursimi	Falas			
Depozitime cash nga pale të treta në llogari kursimi (Llogaria mund të jetë individ/ biznes)	<ul style="list-style-type: none"> 150 LEK për shumat deri në 150,000 LEK (për depozitime në të gjitha monedhat) 750 LEK për shumat mbi 1,500,000 LEK (për depozitime në të gjitha monedhat) 			
Depozitime cash nga klient rastit në një llogari kursimi (Llogaria mund të jetë individ/ biznes)	<ul style="list-style-type: none"> 500 LEK për shumat deri në 1,500,000 LEK (për depozitime në të gjitha monedhat) 1,000 LEK për shumat mbi 1,500,000 LEK (për depozitime në të gjitha monedhat) 			
Konfirmim bankar për marrëdhënie me bankën dhe për balancën e llogarisë	1,000 LEK (Opsionale, sipas kërkesës së klientit)			
Komisioni mbi balancën minimale ne llogarine e kursimit (Falas per muajin e hapjes se llogarise) <i>Komisioni mbi balancën minimale eshte i aplikueshem vetem nese nuk arrihet minimumi i balancën* dhe aplikohet ne baze mujore</i>	150 LEK	1.5 EUR	1.5 USD	1.5 GBP
Balanca minimale*	50,000	500	500	500
Likuidimi i interesit (shembull ilustrativ)				
Shuma	100,000 LEK			
Interesi bruto	200 LEK			
Taksa	30 LEK			
Interesi neto	170 LEK			
Periodiciteti i interesit dhe pagesës së taksave	Çdo fund muaji			
Data e likuidimit të interesit (çdo fund muaji)	Çdo fund muaji			

Tërheqja para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat

Tërheqja nga Kontrata

Nëse klienti ka vetëm një llogari në bankë dhe e mbyll atë brenda 3 muajve, klienti do të paguaj një komision prej 30 EUR.

Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore

Çdo ndryshim i kushteve, i cili përcaktohet në mënyrë të shprehur në kontratën e llogarisë së kursimit, do të jetë efektiv pas dakordësisë me shkrim të palëve. Asnjë ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në kontratë nuk do të jetë efektiv nëse nuk janë dakordësuar me shkrim midis palëve.

Ankesat

Ankesat do të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:

- Në formë shkresore përmes postës zyrtare të bankës;
- Në "Kutinë e ankesave & sugjerimeve" që ndodhet në degë (Ju dëgjojmë 100%);
- Ankesa me shkrim të cilat dërgohen nëpërmjet faqes të internetit të bankës në adresën zyrtare të email-it: complain@intesasnpaolobank.al
- Në Qendrën e Kontaktit : 08006000

Koha e kthimit të përgjigjes nga ana e Bankës është maksimumi brenda 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.

Fjalorth i termave

Specimen - Specimeni i nenshkrimit, është një dokument i dedikuar ku personat që janë të autorizuar të administrojnë ose të nenshkruajnë për një llogari, do të depozitojnë nenshkrimet e tyre në bankë. Bazuar në nenshkrimin e depozituar, Banka do të lejojë disponimin e llogarisë sipas urdhrave të personave të autorizuar të Klientit.

ASD- Agjencia e Sigurimit të Depozitave (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, e cila ushtron funksionet e saj, me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014, "Për Sigurimin e Depozitave".

Interesi Neto- vlera bruto e interesit minus tatimin në burim

Tatimi në burim është një kërkesë e qeverisë për pagesin për një të ardhur të tatueshme në burim ose tatimin e zbritshëm nga pagesa në favor të qeverisë .Ky tatim aplikohet më së shumti në të ardhurat nga puna , pagesa interesash ose dividendë.

Penalitet- Vlera e interesit e gjeneruar por jo e përfituar prej klientit

Specimen - Specimeni i nenshkrimit, është një dokument i dedikuar ku personat që janë të autorizuar të administrojnë ose të nenshkruajnë për një llogari, do të depozitojnë nenshkrimet e tyre në bankë. Bazuar në nenshkrimin e depozituar, Banka do të lejojë disponimin e llogarisë sipas urdhrave të personave të autorizuar të Klientit.